



GSRM

KOMISIONE TË APLIKUARA NGA NDËRMJETËSIT FINANCIAR

Material Infomues

INFORMACIONI MBI KOMISIONET PËR VEPRIMET E BONOVE TË THESARIT QË APLIKOHEN NGA ALPHA BANK

1. Komisioni që mbahet për ç'do aplikim të klientit për të marrë pjesë në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë është në shumën prej 500 (Pesëqind) lekë për aplikim, i cili mbahet në momentin e aplikimit.

2. Në rast se klienti do të blejë nga portofoli i bankës, atëherë nga ana e bankës nuk aplikohet asnjë komision por në bazë të ditëve të mbetura në maturim bëhet përlllogaritja e çmimit të blerjes.

Shembull:

Në rast se klienti do të blejë Bono Thesari nga portofoli i bankës me maturim 1- vjeçar me yield-in të barabartë me 8% për vlerën nominale 5.000.000 lekë dhe ditët që kanë mbetur deri në maturim janë 220, atëherë çmimi i blerjes do të jetë 4.769.995 lekë.

3. Për shitjen e Bonove të Thesarit nga ana e klientëve të bankës, përpara datës së maturimit, nga ana e bankës nuk aplikohet asnjë komision bankar por në bazë të ditëve të mbetura në maturim bëhet një përlllogaritje e çmimit të shitjes së bonos së thesarit.

Shembull:

Në rast se klienti do të shesë një Bono Thesari me maturim 1-vjeçar me shumë nominale 5.000.000 lekë dhe ditët e mbetura deri në maturim janë 130, në rast se yield-i i ofruar do të jetë 7.8 % atëherë çmimi i shitjes nga klienti do të jetë 4.864.850 lekë.